

VENDIM
Nr. 695, datë 30.10.2019

**PËR PËRBËRJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR
ADMINISTRIMIN E UJËRAVE NDËRKUFITARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 8, dhe të pikës 2, të nenit 22, të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përbërja e Komisionit të Posaçëm për Administrimin e Ujërave Ndërkufitare (në vijim, Komisioni) është, si më poshtë vijon:

- zëvendësministër i ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, kryetar;
- zëvendësministër i ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme, anëtar;
- zëvendësministër i ministrisë përgjegjëse për mjedisin, anëtar;
- zëvendësministër i ministrisë përgjegjëse për furnizimin me ujë të pijshëm dhe kanalizimet, anëtar;
- zëvendësministër i ministrisë përgjegjëse për energjinë, anëtar;
- zëvendësministër i ministrisë përgjegjëse për peshkimin, ujëtimin dhe kullimin, anëtar;
- zëvendësministër i ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen, anëtar.

2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore ka rolin e sekretariatit teknik të Komisionit dhe kryen këto detyra:

- a) organizon mbledhjet e Komisionit dhe njofton anëtarët;
- b) planifikon dhe harton projektaktet, sipas tematikave përkatëse;
- c) realizon çdo detyrë tjetër që i ngarkon kryetari i Komisionit;
- ç) raporton periodikisht pranë Kryeministrit për veprimtarinë e Komisionit.

3. Komisioni ngarkohet për administrimin e ujërave ndërkufitare, administrimin e marrëdhënieve me shtetet kufitare për këto ujëra, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar, në marrëveshjet ndërkombëtare, konventat dhe protokollat e nënshkruara nga Republika e Shqipërisë.

4. Komisioni ka të drejtë të krijojë nënkomisione me ekspertë të fushave përkatëse për probleme dhe çështje specifike.

5. Titullarët e institucioneve përgjegjëse të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, caktojnë përfaqësuesit e tyre në këtë Komision.

6. Vendimi nr. 177, datë 26.3.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, përbërjen, funksionimin, përgjegjësitë dhe detyrat e Komisionit të Posaçëm për Administrimin e Ujërave Ndërkufitare”, i ndryshuar, shfuqizohet.

7. Ngarkohen Komisioni i Posaçëm për Administrimin e Ujërave Ndërkufitare, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe institucionet e përmendura në pikën 1, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama